



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
MINISTRI

2528/2
Nr. ___ Prot.

Tiranë, më 23 /11 /2022

URDHËR

Nr. 619, Datë 23.11.2022

“PËR PËRZGJEDHJEN E INSTITUCIONEVE TRAJNUESE PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË DETYRUESHËM TË TRAJNIMIT PËR KANDIDATËT PËR NDËRMJETËS TË PASURIVE TË PALUAJTSHME.

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 7, pika 2, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar, ligjit nr. 9/2022 “Për profesionin e ndërmjetësit të pasurive të paluajtshme”, si dhe urdhrin të Ministrit të Drejtësisë nr. 184, datë 04.05.2022 “Për miratimin e rregullores së programit të detyrueshëm të trajnimit për kandidatët për ndërmjetës të pasurive të paluajtshme”,

URDHËROJ:

Përzgjedhjen e institucioneve trajnuese për realizimin e Programit të Detyrueshëm të Trajnimit për kandidatët për Ndërmjetës të Pasurive të Paluajtshme, si më poshtë:

- a) Shkolla Shqiptare e Administratës Publike (ASP)
- b) Kolegji Universitar i Biznesit (KUB).

1. Ky Urdhër t’i njoftohet menjëherë Shkollës Shqiptare të Administratës Publike (ASP) dhe Kolegjit Universitar të Biznesit (KUB).
2. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Çështjeve Rregullatore të Drejtësisë pranë Ministrisë së Drejtësisë, të marrin masat e nevojshme për zbatimin e këtij Urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

ULSI MANJA

